

VENDIM
Nr. 196, datë 13.3.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË ORTAKËVE “TURK HAVA YOLLARI”
AO, “ALBCONTROL” SHA DHE “MDN INVESTIMENT” SHPK, SI DHE
STATUTIN E SHOQËRISË “AIR ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të vendimit nr. 309, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të krijimit të shoqërisë ‘Air Albania’ sh.p.k., si dhe të vendimit nr. 530, datë 11.9.2018, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e marrëveshjes së ortakëve për statutin e shoqërisë ‘Air Albania’ sh.p.k.’”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së ortakëve “Turk Hava Yollari” AO, “Albcontrol” sh.a. dhe “MDN Investment” sh.p.k., si dhe statutin e shoqërisë “Air Albania” sh.p.k.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “Albcontrol” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama